

Data 14.05.2026

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – SHËRBIME
(PROCEDURË E HAPUR, MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR)
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim mirëmbajtje për infrastrukturës TIK dhe network”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): - Shërbime mirëmbajtjeje- **98341110-9**.

VLERA E FONDIT LIMIT: 48,314,710 (Dyzet e tetë milion e treqind e katërbëdhjetë mijë e shtatëqind e dhjetë) Lekë pa TVSH ose 506,072 (Pesëqind e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e dy) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 14/05/2026 është 95,47 Lekë/Euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare , KESH sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të

prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sa më sipër.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Ligj Nr. 29/2023 PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT (Ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 7.6.2023; aktin normativ nr. 7, datë 14.12.2023; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 27.6.2024; aktin normativ nr. 4, datë 27.11.2024, ligjin nr. 9/2025, datë 30.1.2025; nr. 81/2025, datë 11.12.2025) (i përditësuar), VENDIM Nr. 211, datë 9.4.2025 PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 922, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DEKLARIMIN E DETYRUESHËM TË DEKLARATAVE TATIMORE DHE TË DOKUMENTEVE TË TJERA TATIMORE, VETËM NËPËRMJET FORMËS ELEKTRONIKE”, UDHËZIM Nr. 24, datë 6.11.2025 PËR DISA SHTESA DHE NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E PËRGJITHSHËM NR. 26, DATË 8.9.2023, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 39% e fondit limit, brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Për Autoritetin Kontraktor KESH sh.a, plotësimi i këtij kriteri është i rëndësishëm pasi shërbimet e mëparshme të ngjashme të realizuara në sektorin publik apo sektorin privat janë kushte të nevojshme që garantojnë se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të mëparshme të ngjashme vërtetojnë se zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses këtë procedure prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur dhe te paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, të cilat duhet të përkojnë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- 🚩 SSH/ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- 🚩 SSH/ISO/IEC 20000-1: “Sistemi i menaxhimit të shërbimit”;
- 🚩 SSH/ISO 27001: “Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit”;

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e certifikatave SSH/ISO 9001: SSH/ISO/IEC 20000-1: dhe SSH/ISO 27001: ose ekuivalentit të saj është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë është e nevojshme për të garantuar që operatori ekonomik disponon kapacitetet organizative, procedurat dhe standardet e nevojshme për realizimin korrekt, të sigurt dhe cilësor të shërbimeve objekt prokurimi.

SSH/ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” kërkohet për të vërtetuar se operatori ekonomik zbaton procese të standardizuara të menaxhimit të cilësisë, duke garantuar organizim të brendshëm efektiv, kontroll të proceseve të punës, përmirësim të vazhdueshëm dhe ofrim të shërbimeve në përputhje me kërkesat teknike dhe kontraktuale.

SSH/ISO/IEC 20000-1: “Sistemi i menaxhimit të shërbimit” kërkohet pasi objekti i kontratës lidhet me ofrimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve teknologjike dhe suportit Teknik gjithashtu mbështet menaxhimin e ciklit jetësor të shërbimit, duke përfshirë planifikimin, projektimin, tranzicionin, shpërndarjen dhe përmirësimin e shërbimeve, të cilat përmbushin kërkesat e dakorduara dhe japin vlerë për konsumatorët, përdoruesit dhe organizatën që ofron shërbime. Ky standard garanton që operatori ekonomik disponon procedura të mirëstrukturuara për menaxhimin e incidenteve, monitorimin e performancës së shërbimit, vazhdimësinë operacionale dhe respektimin e niveleve të kërkuara të shërbimit.

SSH/ISO 27001: “Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit” Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshinë kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë të informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë dhe të mos çenohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike. Duke qenë se AK KESH është pjesë e infrastrukturës kritike, siguria e informacionit është thelbësore.

Sa më sipër janë kërkuar certifikata që të vërtetojnë se ofertuesit kanë sisteme menaxhimi sipas standardeve ndërkombëtare të cilat reflektojnë dukshëm edhe në cilësinë e shërbimit. Kërkesat janë të mjaftueshme për të siguruar ofertues me kapacitete teknike cilësore të certifikuar edhe me certifikata menaxhimi të cilësisë të njohura ndërkombëtarë.

Certifikatat e kërkuara për OE janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Certifikatat e kërkuara janë vendosur në përputhje me specifikimet teknike si dhe u arsyetuan të nevojshme për të siguruar ofertues serioze.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të punësuar punonjës të certifikuar nga prodhuesit ose autoritete certifikuese të njohura zyrtarisht nga prodhuesi e pajisjeve ose për produktet që ofrohen, me certifikime si më poshtë:

- ✚ Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar për rrjetat kompjuterike në nivel profesional ose ekuivalent.
- ✚ Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar për pajisjet e rrjetit të tipit Load balancer që do të mirëmbahen.
- ✚ Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar i pajisjeve server që do të mirëmbahen në nivel profesional ose ekuivalent.
- ✚ Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar për pajisjet storage që do të mirëmbahen në nivel profesional ose ekuivalent.
- ✚ Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar në teknologjinë e virtualizimit të datacenter-it, në nivel profesional ose ekuivalent.

- ✚ Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar për infrastrukturën e tipit VDI, në funksion të mirëmbajtjes së infrastrukturës VDI ekzistuese.

Sqarim:

Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certifikatë.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Çertifikatat e mësipërme të vlefshme.
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për muajt Shkurt -Prill 2026.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, pikës 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet, që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë punonjës të certifikuar teknikisht është përcaktuar në funksion të garantimit të kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore për realizimin me cilësi, siguri dhe vazhdimësi të shërbimeve të mirëmbajtjes dhe suportit për infrastrukturën ekzistuese IT, e cila përbëhet nga sisteme dhe pajisje kritike të rrjetit, serverave, storage, virtualizimit, load balancer, VDI dhe infrastrukturës së konvergjuar.

Për shkak të natyrës komplekse dhe kritike të infrastrukturës, është e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë staf me ekspertizë të specializuar në fusha të ndryshme teknologjike, konkretisht:

- ✚ Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar për rrjetat kompjuterike në nivel profesional ose ekuivalent, kërkohet për të garantuar administrimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrjetit dhe komunikimit të të dhënave.
- ✚ Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar për pajisjet e rrjetit të tipit load balancer që do të mirëmbahen, kërkohet për të garantuar konfigurimin, administrimin dhe shpërndarjen efikase të trafikut në sistemet dhe aplikacionet kritike.
- ✚ Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar për pajisjet server që do të mirëmbahen në nivel profesional ose ekuivalent, kërkohet për të garantuar administrimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës serverike dhe të sistemeve kritike të datacenter-it.
- ✚ Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional ose ekuivalent për pajisjet storage që do të mirëmbahen, kërkohet për të garantuar administrimin dhe sigurinë e sistemeve të ruajtjes së të dhënave, si dhe vazhdimësinë e aksesit në informacion.
- ✚ Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar në teknologjinë e virtualizimit të datacenter-it, në nivel profesional ose ekuivalent, kërkohet për të garantuar administrimin dhe

optimizimin e mjediseve virtuale ku operojnë sistemet dhe shërbimet kryesore të Autoritetit Kontraktor.

- ✦ Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar për infrastrukturën e tipit VDI, kërkohet për të garantuar mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës ekzistuese të desktopëve virtualë dhe aksesit të përdoruesve.

Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certifikim, me qëllim moskufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë dhe krijimin e fleksibilitetit në organizimin e stafit teknik, ndërkohë që ruhet niveli i kërkuar i ekspertizës profesionale.

Kërkesa për paraqitjen e kontratave të punës, listëpagesave dhe certifikatave përkatëse synon të vërtetojë disponueshmërinë reale të stafit të deklaruar dhe autenticitetin e kualifikimeve teknike të kërkuara, në funksion të garantimit të kapaciteteve profesionale për realizimin me sukses të kontratës

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, i cili vërteton të drejtën për ofrimin e shërbimeve të suportit dhe mirëmbajtjes për produktet dhe sistemet që janë objekt i kontratës.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të shërbimeve të kërkuara. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve për suportin e pajisjeve që do të mirëmbahen garanton se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, bën të mundur sigurimin e suportit dhe shërbimeve të garantuara për produktet dhe shërbimet sipas TOR.

Për të qenë sa më transparent dhe për të sqaruar sa më saktë operatorët ekonomik mbi këtë kërkesë në termat e referencës janë paraqitur dhe pajisjet e instaluar me Nr. serial përkatës. Sipas këtyre përshkrimeve shihet qartazi që pajisjet ekzistuese për të cilat kërkohet rinovimi i suportit dhe licencave janë të prodhuesve ndërkombëtarë pasi normalisht nuk ekziston kompani shqiptare e cila prodhon pajisje për infrastrukturë dhe rrjet informatike.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë Servis i Autorizuar nga Prodhuesi HP i produkteve Server.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori duhet të paraqesë Kontratën e Servisit të lidhur me prodhuesin HP.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë Servis i Autorizuar nga Prodhuesi IBM i produkteve Storage.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori duhet të paraqesë Kontratën e Servisit të lidhur me prodhuesin IBM.

Argumentimi:

Kërkesat në lidhje kriterin 2.3.5 dhe 2.3.6 ku kërkohet servis i autorizuar nga prodhuesit HP dhe IBM janë në përputhje me nenin 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Për sa i takon kërkesave për kualifikim se OE duhet të jetë servis i autorizuar nga prodhuesit HP dhe IBM vijnë si rrjedhojë e pajisjeve të cilat kanë nevojë për mirëmbajtje dhe suport. Servisi i Autorizuar i jep sigurinë AK mbi autenticitetin e pjesëve dhe shërbimeve të specializuara.

Konkretisht:

-Kërkesa për pajisjet HP Server është e nevojshme për të garantuar që shërbimet e suportit dhe mirëmbajtjes do të realizohen nga një subjekt i njohur dhe i autorizuar zyrtarisht nga vetë prodhuesi, duke garantuar akses në procedurat teknike, dokumentacionin zyrtar, firmware-et, përditësimet dhe pjesët origjinale sipas standardeve të prodhuesit.

-Kërkesa për pajisjet IBM Storage është e nevojshme për të garantuar administrimin dhe mirëmbajtjen e sigurt të sistemeve të ruajtjes së të dhënave, të cilat përbëjnë komponentë kritikë për vazhdimësinë operacionale dhe integritetin e informacionit të Autoritetit Kontraktor. Autorizimi nga prodhuesi garanton që ndërhyrjet teknike kryhen sipas standardeve të prodhuesit dhe me suport të certifikuar.

Sikurse shpjegohet edhe në termat e referencës konkretisht pika “Objekti i shërbimit” citohet:

Nëpërmjet shërbimit të suport kërkohet:

- *Rinovimi i kontratave të suportit dhe të garancisë me prodhuesit;*
- *Përditësimi falas i programeve dhe pajisjeve;*
- *Akses në portalet e prodhuesve për marrjen falas të versioneve të reja të produkteve;*
- *Garancinë falas të pajisjeve minimalisht në termin ‘Ditën tjetër të Biznesit’;*
- *Ofrimin e një qendre të vetme suportit për të gjithë pajisjet dhe aplikimet përfshirë në këtë projekt;*
- *Ofrimin e shërbimit në distancë me kohe përgjigje 1 orë gjatë periudhës 8x7 si dhe atë të paraqitjes në vend 2 orë pas raportimit.*

Garancia dhe Suporti:

- *Garancia për pajisjet kërkohet të jetë sipas specifikimeve teknike;*
- *Shërbimi i Suportit në Vend si dhe i Rinovimit të licencave do të jetë 1 vit;*
- *Suport për të gjitha pajisjet kërkohet të jetë për 1 vit 8x5 me paraqitje on-site 2 orë;*
- *Gjatë periudhës së suportit kërkohet gjithashtu instalimi i versioneve të reja të sistemeve dhe të programeve pa kosto shtesë;*

- *Suport dhe garancia duhet të përmbajë zëvendësimin falas për hardware si dhe përditësimet me versionet e fundit për software pa kosto shtesë.*

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure) ku në të citohet se:

Sistemi VDI është një sistem i përbërë nga 2 servera DELL dhe bazohet në virtualizimin “VMware vSphere Foundation 8 for VDI”, ndërsa për desktopet virtuale përdoret sistemi “OmniSSA Horizon 8 Advanced Term with VVF for VDI Edition”. Për këtë sistem kërkohet suport për pajisjet fizike, si dhe rinovim i licencave VMware dhe OmniSSA për një periudhë 1-vjeçare.

Rrjeti i KESH përmban një sërë switch-esh dhe firewall-esh. Për këto pajisje kërkohet suport nga prodhuesi për pjesën hardware dhe software. Ky suport konsiston në riparimin e pajisjeve ose zëvendësimin e tyre në rast defektesh, si dhe përditësimin e programeve të këtyre pajisjeve në versionet më të fundit.

Një pjesë e infrastrukturës së KESH përbëhet nga shasia HPE C700 dhe servera Blade. Kjo shasi lidhet me storage IBM FlashSystem 5100. Kjo infrastrukturë mban sisteme kritike të KESH dhe për këtë arsye kërkohet suport për pajisjet hardware.

Për arsye sigurie, KESH ka vendosur Barracuda Load Balancer brenda rrjetit të tij, me qëllim rritjen e performancës dhe sigurisë. Shërbimet nuk aksesohen drejtpërdrejt nga përdoruesit, por nëpërmjet Load Balancer-it, duke krijuar një nyje sigurie ndërmjet përdoruesve dhe sistemeve. Për këto pajisje kërkohet suport si për pjesën hardware, ashtu edhe për software.

KESH ka gjithashtu të instaluar një central telefonik për nevojat e komunikimit ndërmjet punonjësve. Centrali është “Cisco Business Edition 6000”. Për këtë sistem kërkohet suport si për pjesën hardware, ashtu edhe për licencat.

Spektori TIK ka të instaluar disa shërbime mbështetëse për monitorimin dhe menaxhimin e platformave të instaluar në tërësi. Këto shërbime janë përshkruar më poshtë:

- Sistemi i filtrimit të internetit “Cisco Web Appliance”
- Sistemi i filtrimit të email-eve “Cisco Secure Email”
- Sistemi i mbrojtjes nga viruset “Trellix Antivirus MVision Protect”
- Sistemi i menaxhimit dhe raportimit të incidenteve “ManageEngine ServiceDesk Plus”
- Sistemi i menaxhimit të pajisjeve dhe aplikacioneve “ManageEngine Endpoint Central”
- Sistemi i auditimit të shërbimeve “ManageEngine AD/File Server Audit”

Për këto sisteme kërkohet rinovimi i licencave, pasi ato janë licenca me afat kohor (“subscription”).

Për ndërtimin e dokumentit të specifikimeve teknike janë zbatuar standardet dhe praktikat më të mira të teknologjisë së informacionit. Shërbimi i kërkuar konsiston në mirëmbajtje (suport) dhe rinovim licencash. Për shkak të kompleksitetit të pajisjeve dhe shërbimeve që janë instaluar dhe konfiguruar në infrastrukturën e KESH, duke përfshirë edhe lidhjen ndërmjet zyrave qendrore dhe njësive të prodhimit, janë përfshirë në këtë shërbim të gjitha detajet teknike të pajisjeve dhe sistemeve, si dhe specifikimet teknike përkatëse, ku përcaktohen numrat serialë dhe versionet e aplikacioneve.

Njesia e prokurimit